

KONTRATE SHITBLERJEJE



SHITESI : **LUIGI TRIGARI**, i biri i Alessandros dhe Pasqualines, lindur me 28.05.1955 ne Fossano, banues ne via Lancimano N. 30, CAP 12045, FOSSANO (CN) - ITALI, me pasaporte N. 888096 M.

BLERESIT: **1.ALDO BOETTI**, i biri i Maorizio Marios dhe Maria Madalenes, lindur me 18.11.1962 ne Mondovi, banues ne via San Bernolfo N 68/K, Cap. 12084, MONDOVI - ITALI, me pasaporte N. 890225M.

2.RAF PILIKA, i biri i Rikos dhe Elianes, lindur me 25.03.1972 ne Tirane, banues ne rrugen Hoxhe Vokrri P.19/1 Ap.3, TIRANE - SHQIPERI, me leter njoftimi N.QH331276

deklarojne se bejne kete kontrate shitblerjeje kuotash per te futur si ortak ne shoqerine A Bi Esse sh.p.k. Aldo Boettin dhe Raf Piliken.

Luigi Trigari eshte ortak ne shoqerine A Bi Esse sh.p.k, te rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, me numer vendimi 11918, me date 24.08.1995, qe ka ndryshuar pjesemarrjen ne kapitalin themeltar me vendimin e Gjykates nr.11918/1 te dates 27.07.1996. Ai zoteron 37.5 kuota, nga kuota me numer 37.6 - 75. Vlera nominale e seciles kuote eshte 1000 leke, pra ai zoteron nje vlere prej 37 500 lekesh.

Sipas vendimit te asamblese se ortakëve te dates 25.10.1996, ai ka vendosur t'i shese 12.5 kuota, nga numri 37.6 - 50, Raf Pilikes, per nje vlere prej 12 500 lekesh dhe 15 kuota, nga numri 51 - 65, Aldo Boettit, per nje vlere prej 15 000 lekesh, duke mbajtur vete 10 kuota, nga numri 65 - 75.

Raf Pilika deklaronte se eshte dakord te bleje 12.5 kuota, nga kuota 37.5 - 50, nga kuotat e Luigi Trigarit, per nje vlere prej 12 500 lekesh, duke u futur si ortak ne shoqerine A Bi Esse.

Aldo Boetti deklaronte se eshte dakord te bleje 15 kuota, nga numri 51 - 65, nga kuotat e Luigi Trigarit, per nje vlere prej 15 000 lekesh, duke u futur si ortak ne shoqerine A Bi Esse.

Mbas shitblerjes se kuotave, ortakët do te zoterojne perkatesisht:

RAF PILIKA
ALDO BOETTI
LUIGI TRIGARI

zoteron kuotat nga 37.5 - 50, d.m.th. 12.5 % te kapitalit,
zoteron kuotat nga 51 - 65, d.m.th. 15 % te kapitalit,
zoteron kuotat nga 66 - 75, d.m.th. 10 % te kapitalit.

Kjo kontrate shitblerjeje u hartua ne tri kopje me fuqi te barabarta ligjore dhe, pasi u lexua e u ra dakord midis paleve, u nenshkrua prej tyre rregullisht.

SHITESI

Luigi Trigari



BLERESIT

Aldo Boetti



Raf Pilika

